

**DREJTËSIA DHE FORMAT POLITIKE NË FILOZOFINË POLITIKE TË
ARISTOTELIT**

TEMA PËR TITULLIN:
MASTER I FILOZOFISË

NGA:

VLORA TASHOLLI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI FILOZOFISË

PRISHTINË

DHJETOR, 2021

“DREJTËSIA DHE FORMAT POLITIKE NË FILOZOFINË POLITIKE TË ARISTOTELIT”

MENTORI:

Prof. Ass. Dr. BLERIM LATIFI

Ky punim ka për objekt trajtimi dialektikën e marrëdhënieve midis drejtësisë dhe formave politike, dialektikë e cila përbën fokusin qendror të veprës “Politika” të Aristotelit. Punimi është strukturuar nga hyrja dhe gjashtë kapituj .

Në **HYRJE** elaboroj kornizën e përgjithshme të çështjes të cilën do ta trajtojë në punim përfshirë mënyrën e organizimit dhe strukturimit metodologjik , si dhe kontekstin e përgjithshëm të filozofisë së Aristotelit.

Në **KAPITULLIN E PARË**, duke u nisur nga parimi kontekstualist që them se secila filozofi politike është e rrënjësuar në realitetin e kohës së saj, elaboroj botën politike të Greqisë Antike, brenda të cilës zhvillohet vetë filozofia politike e Aristotelit. Këtu ndalem në paraqitjen e pluralitetit të madh të regjimeve politike, i cili e karakterizonte Greqinë e kohës së Aristotelit. Është pikërisht ky pluralitet nga e marrin frymëzimin diskutimet e para me karakter filozofik, diskutimet që arrijnë nivelin më të lartë të refleksionit në “Politikën” e Aristotelit.

Në **KAPITULLIN E DYTË**, merrë në shqyrtim raportet midis etikës dhe politikës në filozofinë politike të Aristotelit, duke marrë parasysh faktin se etika dhe politika, ashtu si tek Platoni, edhe tek Aristoteli, nuk janë sfera të veprimtarisë njerëzore të shkëputura nga njëra tjetra, por të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën, në atë që nga studiuesit quhet “uniteti etiko-politik i teorisë politike antike”.Ku ndalem në trajtimin e hollësishëm të faktit se koncepti i Aristotelit mbi drejtësinë ndërtohet mbi premisa të etikës.

Pjesë e këtij trajtimi është edhe analiza e hollësishme e virtyteve themelore të cilat e konstituojnë bashkësinë etiko-politike të polisit antik, siç janë drejtësia dhe miqësia. Po në këtë kapitull i kushtoj një vëmendje të duhur etikës familjare, e cila përbën njërën nga pjesët hyrëse të “Politikës” së Aristotelit.

Në **KAPITULLIN E TRETË**, shqyrtoj bazat antropologjike të filozofisë politike të Aristotelit. Arsyeja pse e bën të domosdoshëm këtë kapitull, është fakti se në filozofinë politike secila teori mbështetet mbi një koncepton të caktuar mbi natyrën njerëzore.

Duke elaboruar gjerësisht konceptin e Aristotelit mbi njeriun si “ qenie politike” (Zo en politikon), i hapi shteg shtrimit të çështjes themelore, e cila shfaqet menjëherë pas antropologjisë politike aristoteliane, e që është çështja e drejtësisë.

Njeriu është qenie sociale dhe pikërisht duke qenë e tillë drejtësia përbën preokupimin themelor të ekzistencës së tij në bashkësi.

Në KAPITULLIN E KATËRT, elaboroj gjithë debatin filozofik mbi drejtësinë që zhvillohet midis Aristotelit dhe platonistëve, duke evidentuar në pjesën e parë kritikën e Aristotelit ndaj tyre dhe në pjesën e dytë duke na dhënë një paraqitje të thuktë të konceptit që Aristoteli e ndërton mbi drejtësinë. E theksoj faktin se Aristoteli, për dallim nga Platoni, e shikon drejtësinë nga një perspektivë më empirike dhe më pak normativiste e idealiste, por pa e harruar faktin se Aristoteli pajtohet me Platonin në pikëpamjen se drejtësia përbën kriterin dhe metodën themelore përmes të cilës duhet të zgjidhet problemi etik i regjimit më të mirë politik, problem i cili përbën vetë substancën e filozofisë politike. Kur ta kemi definuar drejtësinë, atëherë ne mund të lëvizim më tutje për të përcaktuar vlerën etike të secilit prej regjimeve politike.

Në KAPITULLIN E PESTË, shqyrtoj detalisht dialektikën e marrëdhënieve midis formave të regjimeve politike dhe duke aplikuar konceptin e drejtësisë së Aristotelit në këtë dialektikë, arrij të japë pasqyrën e plotë të klasifikimit që Aristoteli ua bën regjimeve politike në regjime të drejta dhe regjime të korruptuara. Regjime të drejta politike janë ato në të cilat pushteti ushtrohet në funksion të së mirës së përgjithshme, e cila është identike me drejtësinë. Kur pushteti devijon nga ky funksion dhe në vend të tij ushtrohet si një mekanizëm i mbrojtjes dhe avancimit të të mira partikulare në bashkësinë politike, atëherë lindin regjimet e korruptuara. Theksoj karakterin dinamik të marrëdhënieve midis regjimeve të drejta dhe të korruptuara, gjë që nënkupton se këto regjime ushqehen nga kriza e njëra tjetrës.

Në KAPITULLIN E GJASHTË, shqyrtoj detalisht përfytyrimin e përgjithshëm filozofik që Aristoteli e zhvillon mbi natyrën e jetës politike të bashkësisë njerëzore. Aristoteli ka një pikëpamje ciklike mbi këtë natyrë. Për të jeta politike njerëzore i ngjanë një cikli gjatë të cilit format politike e prodhojnë njëra tjetrën në një cikël të mbyllur që përsëritet vazhdimisht. Kjo do të thotë se asnjë regjim i drejtë politik nuk është imun nga procesi i korrupsionit dhe pastaj vetë regjimet e korruptuara e krijojnë nevojën për rikthim në regjimet e drejta, të cilat pastaj përsëri korruptohen dhe kështu cikli përsëritet vazhdimisht. Ideja themelore e Aristotelit është se jeta politike njerëzore është një luftë e përhershme midis parimit të drejtësisë dhe parimit të korrupsionit politik, apo thënë ndryshe një luftë e përhershme midis interesit të përgjithshëm dhe atyre partikulare (individuale dhe grupore).

Në përmbyllje të punimit unë mundohem ta jap mendimin tim sa i përket politikës .

Mësimi themelor i Aristotelit është se drejtësia përbën thelbin e jetës në bashkësinë njerëzore, pra edhe vetë kuptimin e ekzistencës së shtetit .